



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2018

V E N D I M

Nr. 142, Datë 28 / 06 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.72 Regj., datë 23.05.2018, të shoqatës “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome¹”, (LRER) kundër gazetarit A. Ç, me pretendimin për diskriminim për shkak të “racës”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve

Bazuar në informacionin e ardhur nga shoqata “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome” (LRER), lidhur me emisionin e datës 21.05.2018 të televizionit Fax News, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është informuar rreth faktit se z.Ç ka përdorur shprehje dhe gjuhë fyese kundrejt komunitetit rom.

Në ankesën ardhur pranë Komisionerit citohet se: *“Tema e diskutimit në këtë emision kishte lidhje me audio përgjimin e vëllait të Ministrit të Brendshëm, gjatë diskutimit për të treguar që kjo bisedë është shumë e rëndësishme, gazetari A. Ç u shpreh se “nuk jemi duke fol për jevgjit në rrugë”.* Përdorimi i fjalëve të tilla në media, theksohet në ankesën e sjellë nga LRER, nxit mendimin se kjo pakicë është inferiore dhe rrjedhimisht nxit forma të ndryshme diskriminimi, për pasojë shprehja e përdorur ishte e pavend dhe jashtë kontekstit të bisedës.

¹ Regjistruar me Vendimin nr.3754, datë 11.02.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi për shkak të racës është shkak i mbrojtur nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

1. Me shkresën me nr.735/1 prot., datë 28.05.2018 i është kërkuar informacion z.A. Ç lidhur me pretendimin e LRER.

Megjithë tejkalimin e afatit 30 (tridhjetë ditë), z.Ç nuk ka kthyer asnjë përgjigje shkresore lidhur me sa i është kërkuar nga Komisioneri. Theksojmë se z.Ç i është dërguar edhe e-mail kujtesë lidhur me informacionin që kërkohej nga Komisioneri³. Po ashtu, referuar kuponit postar Lajmërim Marrje me kod postar: RR 290 331 074 AA z.Ç ka marrë dijeni me datë 29.05.2018.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, bazuar në faktet e mësipërme dhe në analizë të legjislacionit në fuqi, Komisioneri vëren se:

² Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

³ Me datë 19.06.2018 i është dërguar e-mail në adresën: arturciani@gmail.com (adresë e dhënë nga vetë z.Çani)

Për faktet që janë të njohura publikisht, bazuar në nenin 80/3 të Kodit të Procedurave Administrative, ku sanksionohet se : *"Për faktet të cilat janë të njohura publikisht, si dhe për ato fakte të cilat janë të ditura për organin administrativ për shkak të funksioneve të tij, nuk nevojitet verifikim "*, nuk lind nevoja për verifikim.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionon në nenin 18 se : *"Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatesia prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektiv".*

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njih dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë "në gëzimin e të drejtave dhe lirive" të përcaktuara në të. Protokollin 12 i saj ndalon diskriminimin në lidhje me "gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji" dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.⁴

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë mbron njëkohësisht lirinë e shprehjes në nenin 22 të saj ku parashikohet se: *"Liria e shprehjes është e garantuar"*, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Kështu, në nenin 17 të saj sanksionohet se: *"Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*. Pra, shohim se, Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkalar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

⁴ Protokollin 12-të i KEDNJ-së.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Shprehja e përdorur nga gazetari A. Ç nxit haptazi ndjenja përbuzjeje ndaj komunitetit rom dhe egjiptian. Në çështjen “Feret kundër Belgjikes”, GJEDNJ, ka mbajtur qëndrimin se: *“...një ligjeratë e tillë në mënyrë të paevitueshme do krijojë mes publikut-e vecanërisht mes atyre anëtarëve të publikut që nuk janë të mirëinformuar-ndjenja keqkuptimi, madje refuzimi e te disa, edhe urrejtje”*.

Dinjiteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, sanksionohet në nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i çenojë vetë ato, por ai duhet të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të siguruar mos cënimin, për t’i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010, sanksionohet se : *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etnine, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqerore, shtatzanine, perkatesine prinderore, pergjegjesine prinderore, mos hen, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shendetesore, predispozicione gjenetike, aftesine e kufizuar, perkatesine ne nje grup te vecante, ose me cdo shkak tjetër”*.

Raca është shkak i cili gëzon mbrojtje nga ligji dhe bazuar në nenin 32/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me racën.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektoret publike ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Komisioneri mirëkupton dhe respekton të drejtën e çdo individi për të shprehur mendimet dhe opinionin e vet personal lidhur me çështje të ndryshme, mirëpo vëren se se një gjuhë e tillë çon ineresat, dinjitetin dhe të drejtat themelore të komunitetit rom dhe egjiptian në Shqipëri dhe nxit urrejtjen ndaj tyre.

Për këtë arsye, gjuha e përdorur nga gazetari A. Ç do të konsiderohet në tejkallim të lirisë së shprehjes të sanksionuar në nenin 22 të Kushtetutës, referuar kufizimeve që parashikon Konventa për lirinë e shprehjes, të parashikuar në nenin 10 të saj dhe qëndrimin të mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka theksuar në gjykime të ndryshme se: *“Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si çështje parimore mund*

të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike që të sanksionojnë ose madje të parandalojnë të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në jo tolerancë ..., me kusht që çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizimet ose gjokat” janë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur”. (Erbakan v. Turkey). Duke qenë kështu lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës.

Komisioneri vlerëson se gjuha e përdorur (“*nuk jemi duke fol për jevgjit në rrugë*”.) në emisionin e datës 21.05.2018 të televizionit Fax News, nga ana e z.A. Ç është një rast flagrant i shkeljes së dinjitetit të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë e ka theksuar këtë fakt në çështjen Feryn⁵ ku është shprehur se: “*...mosndëshkimi i një sjelljeje diskriminuese kaq të hapur do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së Direktivës për barazi bazuar në shkaqe raciale*”.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në çështjen e firmës Feryn, ka mbajtur qëndrimin dhe ka pranuar se diskriminimi i drejtpërdrejtë mund të shfaqet edhe në ato raste kur nuk mund të identifikohet ankuesi. Për rrjedhojë duke mos patur nevojë për një viktimë, nuk lind nevoja as për të identifikuar një krahasues. Duke qenë se, paligjshmëria e sjelljes është aq flagrante, standardi të cilit Komisioneri i është referuar, është ai i një “standardi të vërtetë” që duhet të ekzistojë në një shoqëri demokratike, siç kërkohet nga pika 2, e nenit 3, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në çështjen në fjalë, Komisioneri mban parasysh faktin e rëndësishëm që mediat audiovizive ndiqen nga shumë njerëz dhe pjesëmarrësit në këto emisione (siç është rasti i z.Ç) janë persona publikë që kanë impakt në publikun që i ndjek. Lufta kundër mungesës së tolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit. Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se, përhapja e veprimeve të tilla nëpërmjet mediave audiovizive përbën një mjet të fuqishëm të ndikimit në publik dhe mund të ndikojë në mbajtjen e qëndrimeve negative, agresive dhe diskriminuese për të gjithë individët apo komunitetin rom dhe egjiptian në Shqipëri.

Duke iu referuar çështjes Delfi AS kundër Estonisë⁶, vërejmë se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashtroi se: “*...duhet të mbahet përgjegjësi, në parim, për gjuhë shpifëse ose të llojeve të tjera të paligjshme dhe kjo të përbëjë mjet efektiv ndaj cënimit të personalitetit të individëve*.”

⁵ Centrum voor gelijkheid van kansen en voor racismebestrijding kundër firmës Feryn NV, C-54/07, 10 korrik 2008

⁶ Delfi AS kundër Estonisë, çështja nr. 64569/09, Vendimi datë 10.10.2013, Nota Informative 167.

Në çështjen Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë GJEDNJ-ja mban qëndrimin se, në disa raste ndërhyrja në lirinë e shprehjes është e domosdoshme në një shoqëri demokratike, për shkak të mbrojtjes së reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve.

Toleranca dhe respekti për dinjitet të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si një çështje parimi mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës⁷. E drejta e individëve, për të shprehur lirisht mendimet e tyre nuk duhet të “fyejë, tronditin apo shqetësojnë” të tjerët⁸.

Në nenin 3/5 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Shqetësim” është ajo formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqtësor, përçmues, poshtëruar a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë”.*

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5 dhe 7 të Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasve që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian nga ana e gazetarit A. Ç, për shkak të racës, në formën e shqetësimit.
2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, z.A. Ç, të dalë me një deklaratë publike (verbale apo të shkruar) me anë të së cilës distancohet nga përdorimi i një gjuhe të tillë e cila paragjykon haptazi dhe në mënyrë flagrante prek dinjitetin e personave të komunitetit rom dhe egjiptian.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, z.A. Ç, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat konkrete të marra për zbatimin e këtij vendimi.

⁷ Çështja Erbakan kundër Turqisë, 6 korrik 2006, GJEDNJ.

⁸ Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, çështja nr. 5493/72, 07 dhjetor 1976.

4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

(shkaku: raca)

(fusha: të mira dhe shërbime)